



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2425, datë 27.02.2014

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a ndaj Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 2406 datë 26.12.2013 mbi miratimin e dokumentit “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Iris Khanaj, në mbledhjen e datës 27.02.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sha ndaj Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 2406 datë 26.12.2013 mbi miratimin e dokumentit “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri””

BAZA LIGJORE:

1. Neni 41, 114 dhe 115 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 9918, i ndryshuar*);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (K.Pr.A);

3. VKD 2406 26.12.2013 mbi miratimin e dokumentit “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”

K Ë SH I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Vodafone Albania sh.a. me Referencë: LRD/0019/OX, datë 24.1.2014, (AKEP nr.163, datë 28.01.2013) me të cilën ka paraqitur “Ankim administrativ i Vodafone Albania ndaj Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2406, datë 26.12.2013, 26.12.2013 mbi miratimin e dokumentit “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”
2. Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 2406 datë 26.12.2013 mbi 26.12.2013 mbi miratimin e dokumentit “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”
3. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Vodafone Albania sh.a. me anë të shkresës me numër reference LRD/0019/OX datë 24.01.2014 (AKEP nr.163, datë 28.01.2013) kërkon të ndryshojë VKD nr.2406 datë 26.12.2013. Vodafone vëren se dokumenti “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri” u miratua nga AKEP më 26.12.2013, pas një procesi të gjatë pune që përfshiu diskutime, tryeza të rrumbullakta dhe këshillim publik, por Vodafone gjykon se zbatimi i detyrimit për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos nuk është i justifikuar në kushtet aktuale të tregut, është jo proporcional dhe i papërshtatshëm dhe si rrjedhojë nuk është në përputhje me dispozitat që parashikon Ligji 9918 dt.19.05.2008.
2. Në kundërshtimet e saj Vodafone ka përfshirë midis të tjerave argumentet e mëposhtme:
 - a. Rezultatet e Analizës së tregut të telefonisë celulare nuk justifikojnë ndërhyrjen rregullatore.
VF i referohet “Analizës së tregut të vitit 2012” të miratuar me VKD 2018 dt. 04.07.2012 dhe “Raportit Vjetor 2012” të AKEP, ku theksohet se gjatë periudhës 2010-2012 në treg kanë ndodhur ndryshime të konsiderueshme në pjesë tregu, konkurenca në nivel shitje me pakicë është rritur ndjeshëm, të ardhurat dhe marzhet e fitimit të AMC dhe VF janë ulur dhe simetria midis rrjeteve ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme . Uljet e tarifave të terminimit dhe portabilitetit i numrit kanë luajtur rol në uljen e normave të tarifave celulare në nivel shitjeje me pakicë, vazhdon të theksojë VF në ankesë.
AS/CA është detyrim rregullator kur në treg rregullimi *ex ante* luan rol kryesor për mbrojtjen e konkurrencës, por duke iu referuar akteve të

mësipërme të AKEP, tregu shqiptar ka pasur rritje të konkurrencës , çka nuk justifikon këtë ndërhyrje. Nga ana tjetër akoma nuk është kryer Analiza e tregut për vitin 2012-2013, përfundimet e të cilës mund të justifikonin ndërhyrjet që parashikon VKD 2406.

- b. Masa rregullatore nuk është në përputhje me objektin që parashikon Ligji 9918 për vendosjen e saj.

Transparenca në lidhje me AS referohet nëse ka pasur apo plotësohen dy kriteret: 1) subvencionimi, 2) të pandershëm. Në tregun shqiptar këto dy kriteret nuk plotësohen që të caktohet ky rregullim. Veç kësaj dokumenti i miratuar nga AKEP e shtrin kontrollin edhe në tregjet që nuk janë FNT. Gjithashtu nëse AKEP gjen që operatori aplikon tarifa të paarsyeshme dhe dëmton konsumatorin, atëherë AKEP duhet të vendos detyrime rregullatore për ndarjen e llogarive. Nga Analiza e fundit e tregut, AKEP nuk vuri re dukuri të tilla, aty shprehet se tregu është konkurrent, çmimet janë në rënie dhe konsumatorët përfitojnë më shumë nga produktet e reja. Si rrjedhojë ndërhyrja është e pajustificuar në ligj dhe bie ndesh me dispozitat përkatëse.

- c. Përfitimi nga implementimi i masës rregullatore është i paqartë për tregun, operatorët dhe vetë AKEP ndaj dhe është i paarsyeshëm dhe i pajustificuar përkundrejt kostove të implementimit që mbartin operatorët.

Kostoja e implementimit të masës rregullatore për dy vitet e para e kalon shifrën 1 milion euro, ndërkohë AKEP nuk ka paraqitur asnjë arsye të qartë, të saktë ligjërisht dhe proporcionale që të justifikojë kostot që pëson operatori nga ky rregullim. Sa më sipër vërteton se zbatimi i AS/CA në një formë dhe përmbajtje të tillë siç është miratuar nga AKEP nuk është promocional në arritjen e qëllimit të AKEP.

- d. Detajimi, lloji dhe mënyra e kërkimit të informacionit shkon përtej nevojës për ndërhyrje dhe është jo promocional.

Duke qënë se tregu i shërbimeve të ofruara në segmentin me pakicë nuk është i rregulluar *ex-ante*, atëherë si i tillë ndaj tij nuk mund të vendoset detyrimi AS/CA, i cili është detyrim për MNO dhe Operatorin fiks incumbent me përcaktim FTN. Dokumenti i miratuar nga AKEP nuk argumenton përse FAC/HCA nuk jep informacion të mjaftueshëm për qëllimin dhe nevojat e tyre dhe nuk ka justifikim pse të vendosi CCA/LRIC pasi është i kushtueshëm. Përdorimi i CCA për raportime *ex post* është i gabuar. Ndryshimi ndërmjet CCA dhe HCA është marzhinal. AKEP duhet të kishte shpjeguar në dokument çfarë zgjidh CCA që nuk e zgjidh HCA. Kërkesa për të dhënë në detaje ndryshimet ndërmjet analizës së kostos dhe kostos së përcaktuar nga AKEP për kontrollin e çmimeve nuk është justifikuar në dokument. Për t'i kërkuar një operatori FNT të shpjegojë pse kosto e analizuar *ex post* është e ndryshme nga parashikimi *ex ante* është jo proporcionale dhe është një ushtrim i ngarkuar me vështirësi në llogaritje. Kërkesa për të zbatuar LRIC top down nuk është proporcional. Për të përcaktuar tarifat e terminimit është përdorur modeli bottom up. Paraqitja e të dhënave në bazë të modelit top down nuk provon se AKEP do mund të ketë informacion të dobishëm përtej të dhënave që do të ofroheshin nga FAC. Kostoja e zbatimit dhe mbajtjes së sitemit LRIC nga lart posht i tejkalon përfitimet që një ndërhyrje e tillë mund të sjellë. Më tej përfshirja e CVR ose rrit koston e auditimit në nivel të pakontrollueshëm ose ul probabilitetin e saktësisë së auditimit. Periudha

tranzitore është joproporcionale pasi AKEP ka mbajtur qëndrimin më shtëngues të mundshëm ndaj Operatorëve. Është jo realiste të mendohet se publikimi me audit në vitin e parë mund të arrihet brenda 6 ose 9 muajsh.

- e. Dokumenti i miratuar nga AKEP në lidhje me zbatimin e AS/CA nuk ka marrë në konsideratë eksperiencën e vendeve të BE dhe të rajonit, nga të cilat rezulton se AS/CA nuk është implementuar ndonjëherë në të tilla rrethana.

AKEP nuk ka asnjë referencë dhe përqasje me praktikën e vendeve të BE-së dhe të rajonit, e cila shërben si benchmark për matjen e efikasitetit dhe nivelit të rregullimit në regjimet më të avancuara dhe mbi të gjitha krahasimi me praktikën më të mira është detyrim ligjor i organit rregullator. AS/CS është një masë rregullatore e paprecedentë, nëse i referohemi vendeve të rajonit. Raste të vetme në përvojën e BE-së për zbatimin e AS/CA i referohen operatorëve fikse dhe jo operatorëve celularë. Janë hasur situata të rralla të ngjashme me rastin e vendit tonë në lidhje me AS/CA në teori, por në praktikë nuk janë zbatuar, sidomos në kushtet e LRIC. AKEP duhet të marrë parasysh rekomandimet e KE dhe BEREC, çka në rastin tonë janë anashkaluar nga AKEP pasi për asnjë çast nuk ka referuar nevojën për rregullim të praktikave më të mira evropiane dhe të qëndrimi i organeve të tjerë rregullatorë nëpërmjet dokumentave të tyre të përbashkët.

- f. Në përfundim të ankimit, Vodafone kërkon që mbështetur në argumentat e dhëna dhe bazuar në Ligjin nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, nenet 142 dhe 145, AKEP:
- 1) Të pranojë ankimin administrativ
 - 2) Të ndryshojë aktin administrativ VKD nr.2406 të datës 26.12.2013, në përputhje me ligjin.

3. AKEP pasi ka shlytur ankimin administrativ të Vodafone dhe argumentat e paraqitura gjykon se:

- Argumentet e dhëna nga Vodafone të referuara në pikën 2, gërmat ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’ më sipër, kanë lidhje me vendosjen e masës rregullatore të AS/CA për FNT, dhe diskutimi/argumentimi i vendosjes së kësaj mase rregullatore është bërë në Analizën e tregut celular, të miratuar me VKD Nr. 2118, datë 4.07.2012, në Seksionin III.3, pika IV, për masat rregullatore për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare të katër operatorëve që janë me FNT në këtë treg dhe referencat me Ligjin 9918 dhe rekomandimet e KE dhe BEREC (ERG më parë). Ndaj AKEP nuk është dakort me pretendimet që ngre VF se rezultatet e Analizës së Tregut nuk justifikojnë ndërhyrjen, se masa rregullatore nuk është në përputhje me objektivin që parashikon ligji dhe përfitimi nga implementimi i kësaj mase është i paqartë. Në dokumentin e Analizës shprehet qartë “*Bazuar në gjetjet e analizës rezulton që të katër operatorët AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication janë propozuar si operatorë që kanë Fuqi të Ndjeshme në tregun e terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e tyre. Rrjedhimisht në referencë me përcaktimet e ligjit 9918, propozohet që AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile të vazhdojnë në implementimin e masave rregullatore që aktualisht mbajnë, detyrime të cilat identifikohen të domosdoshme me qëllim shmangien e problemeve të tilla si mungesë*

transparence, diskriminim në tarifa dhe cilësi, mosdhënie aksesit apo vonesa në dhënie e aksesit për terminim. Zbatimi i detyrimeve dhe shmangia e këtyre problemeve avantazhon realizimin e objektivit të përgjithshëm rregullator, sigurimi i konkurrencës efektive, dhe objektivave të tjerë pjesë e nenit 7 të Ligjit 9918. Në mënyrë të përmbledhur detyrimet propozuara për AMC, Vodafone Albania dhe Eagle Mobile janë:

- 1) Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)*
- 2) Detyrimi i transparencës (Neni 40)*
- 3) Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)*
- 4) Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)*
- 5) Detyrimi për ndarjen e llogarive (neni 41)”*

Për sa i përket aplikimit në të ardhmen të AS/CA në kushtet e propozimit për rregullim të tarifave të terminimit sipas LRIC të pastër, AKEP do të diskutojë dhe trajtojë vazhdimin apo ndërprerjen e kësaj mase rregullatore (AS) në analizën e tregut celular të rradhës, që pritet të kryhet këtë vit, proces që sipas ligjit do jetë objekt i këshillimit publik.

Përsa i përket kostove të këtij procesi AKEP gjykon se i ka dhënë çdo operatori kohë të mjaftueshme për trajtimin e çështjeve. Detajet e proceseve tenderuese, kërkesat për konsulencë dhe buxhetet e sipërmarrësve janë çështje që u përkasin vetëm operatorëve. Siç përmendet edhe në dokumentin e rregullave dhe udhëzimeve, “*pritet që ngarkesat mbi stafin dhe sistemet të krijuara nga regjimi i ri do të zvogëlohen në mënyrë të konsiderueshme pas vitit të parë ose të dytë të punës*”. Për të mos rënduar procesin, AKEP mori parasysh edhe komentet e bëra nga operatorët dhe kërkoi raportimin nga 2014 e më pas, pavarësisht se në konsultim publik AKEP propozoi fillimin e raportimit për vitin 2013.

- AKEP nuk është dakort me pretendimin se dokumenti i miratuar në këtë formë nuk është proporcional. Parimet njohen mire dhe përmbushin qëllimin e kërkuar nga ligji 9918 (neni 41) dhe ky proces do të nxisë konkurrencën e ndershme dhe si rezultat edhe mirëqenien e konsumatorit në Shqipëri. Në lidhje me detyrimet rregullatore për shërbimet më pakicë ose për shërbimet jo FNT, ka dhënë qëndrimin e tij që në kthimin e përgjigjeve kur materiali ishte në konsultim publik: “*Ndarja e llogarive dhe raportimi financiar rregullator janë masa të pranueshme në tregjet me shumicë ku mos-diskriminimi dhe mungesa e subvencionimit duhet të jenë të provueshme pa ndikuar negativisht në operacionet tregtare. AKEP do të jetë në gjendje t’i përdorë këto masa të reja si një instrument i fuqishëm për nxitjen e konkurrencës dhe mirëqenien e konsumatorit në vitet e ardhshme. Kërkesa për të paraqitur detaje bazë mbi të dhënat financiare lidhur me shërbimet jo-FNT është në pajtim me rekomandimet e BE-së dhe mbron instrumentin në fjalë pa dëmtuar interesat e operatorëve në treg. Detyrimi nuk ka për qëllim të jetë i vështirë apo në kundërshtim me detyrimet FNT për shërbimet jo-konkurrese. AKEP ka bërë një vlerësim të sasisë së informacionit të nevojshëm për të vlerësuar në mënyrë adekuate mosdiskriminim dhe transparencën nga sipërmarrësit FNT*

dhe e kufizon informacionin e kërkuar sipas rrethanave. Kjo mënyrë paraqitje të dhënash është edhe në përputhje me praktikën e BE¹.

- Pretendimi që ka VF, se dokumenti përfundimtar nuk ka argumentuar pse FAC/HCA nuk jep informacion për qëllimet e nevojat e AKEP dhe duhet të kishte provuar pse CCA zgjidh problemet që HCA nuk mund t'i zgjidhi, AKEP i ka dhënë qartë në dokument. Arsyet për zbatimin CCA brenda regjimit të kontabilitetit rregullator janë të bazuara si dhe janë diskutuar në dokumentin e Rregullave dhe Udhëzimeve. Nëse i referohemi dokumentit ai e shpjegon qartë pse CCA është mënyra më e drejtë për të bërë një vlerësim real duke qënë se HCA nuk është model i drejtë për vendim marrje rregullatore ashtu edhe për vendim marrje të brendëshme. CCA-ja pranon pasojat e ndryshimit të çmimeve, zhvillimet teknologjike dhe vlerën për një biznes të aktiveve që përdoren për të ofruar shërbime. Përdorimi i CCA kërkon që sipërmarrësit të rivlerësojnë aktivet dhe mbi këtë rivlerësim të prodhojnë pasqyra financiare përkatëse, duke pasqyruar kështu se çfarë do të rezultonte në kushtet e konkurrencës së plotë në treg, ndaj edhe në këtë pike AKEP mendon se e ka justifikuar drejt përdorimin e CCA/LRIC. AKEP nuk është dakort me pretendimet, sepse në dokument jepet qartë përparësia që ka CCA në krahasim me HCA:

1.Për të patur rezultate të krahasueshme

2.Për të pasur raporte të qëndrueshme,

3.Për të patur raporte transparente

Shumë faktorë që ndikojnë në vlerën e drejtë të tregut të një aktivi HCA nuk i merre parasysh, kurse CCA ndihmon në evidentimin e këtyre faktorëve(ndryshimi i çmimit në treg, faktorët ekonomike, dhe ndryshimet në teknologji) dhe pasqyrimin në vlerën reale të një aktivi. CCA-ja mundëson matjen e performancës financiare nga Sipërmarrësit me FNT në mënyrë të qëndrueshme me kostot me të cilat përballen hyrësit e rinj në treg, duke lejuar rikuperimin e kostove aktuale.

- Për sa i përket komentit të Vodafone të referuar në pikën 2, gërma 'f' më sipër, që AKEP nuk ka marrë në konsideratë përvojën në rajon dhe vendet e BE për vendosjen e masës së AS/CA për operatorët celularë, megjithëse është një diketim i bërë tashmë në Analizën e tregut, takimet e zhvilluara, sqarojmë se sipas Raportit të Cullen International të muajit Shkurt 2014 (dhe raporteve të mëparshme), detyrimi për ndarjen e llogarive për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare është vendosur në Maqedoni, Mal të Zi, Islandë (pjesë e grupit të shteteve të monitoruara nga KE), Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë. Njëkohësisht sipas dokumentit të BEREC, BoR (13) 110, mbi zbatimin e kontabilitetit rregullator, publikuar në Shtator 2013, rezulton që për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, nga 18 vende që kanë raportuar, 16 prej tyre zbatojnë bazën e kostove korrente (CCA) dhe 13 zbatojnë LRIC si metodë alokimi. Njëkohësisht BEREC në përkufizimin e Ndarjes së Llogarive, citon midis të tjerave se¹: *Rezultatet (outputet nga sisteme të tilla (AS) duhet të jenë të verifikueshme (auditueshme) në mënyrë të pavarur dhe të prezantojnë në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe marrdhëniet (rregullimet për*

¹ The outputs from such a system must be capable of independent verification (auditable) and fairly present the financial position and relationship (transfer charge arrangements) between the wholesale and retail activity of the vertically integrated operator.

pagesat e transferimeve) midis aktiviteteve me shumicë dhe me pakicë të operatorit të integruara vertikalisht.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, pika të K.Pr.A,

V E N D O S:

1. Të rrëzojë ankimin administrativ të Vodafone Albania sh.a., depozituar me shkresën me Referencë: LRD/0019/OX, datë 24.1.2014 (AKEP nr.163, datë 28.01.2013) ndaj Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2406, datë 26.12.2013, mbi miratimin e dokumentit “*Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri;*
2. Të njoftohet Vodafone Albania sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

PIRO XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**